



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.07.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
2. **Medi Bici** (anëtar)
3. **Fatmira Luli** (anëtare)
4. **Brunilda Kadi** (anëtare)
5. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
6. **Illir Toska** (anëtar)
7. **Alban Toro** (anëtar)
8. **Brikena Ukperaj** (anëtar)

9. Erjon Muharremaj (anëtar)

10. Marçela Shehu (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zonja Naureda Llagami**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 3. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).**
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Mbledhja plenare e datës 23 korrik 2020, në mungesë të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, e cila për arsye personale nuk merr pjesë në mbledhje, drejtohet nga zoti Maksim Qoku, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, i cili fillimisht prezanton pikat e rendit të ditës. Pas prezantimit të rendit të ditës, zoti Qoku i jep fjalën relatorit të çështjes së parë të rendit të ditës, zotit Ilir Toska për të shqyrtuar pikën e parë të rendit të ditës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues, lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për hapjen e procedurës së komandimit në pozicionin e

ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”. Lexohet relacioni me përmbajtjen e mëposhtme:

“Këshilli i Lartë Gjyqësor, referuar nenit 86 të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së drejtësisë” i ndryshuar, dhe në zbatim të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim referuar si Ligji për Statusin), është organi përgjegjës për emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin dhe riemërimin, vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, vendosjen e masave disiplinore dhe pezullimin, si dhe çdo detyrë tjetër e caktuar me ligj.

Legjislacioni në fuqi, konkretisht Ligji për Statusin ka parashikuar edhe mundësinë e komandimit të magjistratit, me pëlqimin e tij, në institucione të tjera brenda sistemit të drejtësisë, përfshirë këtu dhe në Gjykatën e Lartë, specifikisht në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”. Pika 1, e nenit 56, të Ligjit për Statusin përcakton se: “1. Magjistrati mund të komandohet në Gjykatën e Lartë, ...,me mandat pesëvjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje, me kërkesë të institucionit ku komandohet magjistrati.”. Më tej, në Ligjin nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në ndryshim nga më parë , përcaktohet se pranë Gjykatës së Lartë funksionin Njësia e Shërbimit Ligjor. Kjo Njësi ushtron veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës së Lartë. Në pikën 4, të nenit 34, të këtij ligji, përcaktohet se: “Njësia e Shërbimit Ligjor përbëhet nga këshilltarët ligjorë, në të cilën më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm përbëhet nga ndihmësmagjistratë të komanduar, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ndërkohë, në dispozitat e Ligjit për Statusin, konkretisht në nenet 54, 57 dhe 58, përcaktohet edhe procedura që duhet të ndjek Këshilli, ashtu dhe institucionet e tjera në të cilat magjistrati mund të komandohet, në këto raste.

Nën këto përcaktime ligjore, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur Shkresa nr. 1607 prot., datë 17.07.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr.3381 prot., datë 17.07.2020, e Gjykatës së Lartë, me objekt: “Mbi komandimin e magjistratëve në Gjykatën e Lartë”. Përmes kësaj shkrese, Këshillit i është kërkuar komandimi i 5 (pesë) magjistratëve gjyqtarë në pozicionin e “ndihmësmagjistratit” në Gjykatën e Lartë.

Në vijim të kësaj Shkrese, nga ana e Gjykatës së Lartë është përcjell dhe Shkresa nr. 1607/1 prot., datë 20.07.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3381/1 prot., datë 20.07.2020, me objekt: “Mbi fillimin e procedurës për komandimin e magjistratëve në Gjykatën e Lartë”. Nëpërmjet kësaj shkrese, Gjykata e Lartë parashtron se: “... Përmbushja e disa kriterëve specifike që kërkon pozicioni i ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë do të ndihmonte për nisjen nga ana e Këshilli të Lartë Gjyqësor të procedurës ligjore të komandimit të magjistratëve dhe për shpalljen e kërkesës për kandidatura për plotësimin e pesë pozicioneve të sipërcituara, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet”. Kriteret specifike që kërkon pozicioni i ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 34 të ligjit nr.98/2016 dhe përshkrimit të punës së tyre janë të orientuara në funksionin këshillues dhe ndihmës që magjistrati i komanduar luan në procesin vendimmarrës të Gjykatës së Lartë, në analizimin e praktikës gjyqësore mbi interpretimin e dispozitave të zbatueshme për çështjet në gjykim, në analizimin e çështjeve dhe përmbledhjen e procedurës, si dhe në çdo detyrë tjetër për përpunimin e çështjes, siç kërkohet nga gjyqtari. Në këtë drejtim, është një kusht i domosdoshëm, pasja e përvojës profesionale dhe specializimi i ngushtë i tyre, si në çështje të së drejtës së brendshme, ashtu edhe të asaj ndërkombëtare. / Për këto arsye, preferohet që kandidatët të plotësojnë kriteret specifike, duke u bazuar në disa tregues si: - përvoja profesionale dhe specializimi në fushën administrative, civile ose penale; - njohuri të qarta në jurisprudencën e gjykatave vendase; njohja e juridiksionit ndërkombëtar do të konsiderohet plus; - kryerja dhe dokumentimi i kërkimeve gjithëpërfshirëse ligjore; - rezultatet e studimeve, si dhe performanca në programin e formimit fillestar dhe vazhdues në Shkollën e Magjistraturës; - njohuri të mira, të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian; - aftësi të shkrimit dhe arsyetimit ligjor; - aftësi të shkëlqyera komunikimi me shkrim dhe me gojë; - qenia autor i artikujve, ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës; - mospasja e ndonjë mase disiplinore në fuqi...”.

Për sa më lart, mbështetur në nenin 86, shkronja “d”, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54, 56, 57 dhe 58 të Ligjit për Statusin, në pikën 4, të nenit 34, të Ligjit nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, mbi kërkesën e Gjykatës së Lartë,

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të shpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Gjykatën e Lartë, për pesë pozicione të lira në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”, propozim për të cilin është përgatitur Projektvendimi “Për hapjen e procedurës së komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”.

Sipas këtij projektvendimi shpallet kërkesa për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicionit të “ndihmësmagjistratit” në Gjykatën e Lartë, sikundër përcaktohen afati, dokumentacioni, kohëzgjatja, kushtet dhe kriteret preferenciale të kandidimit, sikurse jepet dhe informacioni për procedurën e komandimit, në përputhje me kërkesat e pikës 3, të nenit 54, të Ligjit për Statusin.

Projektvendimi është i strukturuar në 4 Krerë.

Kreu I i projektvendimit, pikat 1 dhe 2, bëjnë fjalë për hapjen e procedurës dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura, për komandim në Gjykatën e Lartë, për pesë pozicione të lira si “ndihmësmagjistrat”.

Në Kreun II të projektvendimit, pika 3, bën fjalë për afatin e kandidimit, që përcaktohet të jetë deri më datë 04.09.2020, duke pasur parasysh pushimet vjetore të gjyqtarëve gjatë muajit gusht.

Në Kreun e III të projektvendimit përcaktohet dokumentacioni i kandidimit, i cili duhet të paraqitet nga kandidati në momentin e aplikimit e më konkretisht: a) Kërkesa për shprehjen e interesit për të kandiduar për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë; b) Jetëshkrimi, me të dhënat e plota të kontaktit (numër telefoni/e-mail), ku të pasqyrohet, veç të tjerash, çdo e dhënë e mundshme në lidhje me kushtet dhe kriteret preferenciale të komandimit; c) Fotokopje të kartës së identitetit; ç) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi; d) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të shkronjës “a”, pika 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas formularit bashkëlidhur këtij vendimi; dh) Vërtetim nga gjykata/gjykatat për specializimin në fushën administrative, civile ose penale; e) Lista e

rezultateve të studimeve; ë) Vërtetim nga Shkolla e Magjistraturës për pjesëmarrjen në programin e formimit vazhdues dhe përfshirjen në veprimtaritë trajnuese; f) Certifikatë/Dëshmi për zotërim gjuhe të huaj; g) Pesë dokumente ligjore, vendime gjyqësore, artikuj apo botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës; gj) Rekomandime për aftësitë e komunikimit me shkrim dhe me gojë; h) Çdo dokument tjetër, që tregon plotësimin e kriterëve preferenciale të komandimit. Në pikën 5 të këtij Kreu, përcaktohet vendi i dorëzimit të dokumentacionit, që është pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në Kreun IV të projektvendimit jepet informacion për kohëzgjatjen, kushtet, kriteret preferenciale dhe procedurën e komandimit.

Kështu, në pikën 6 të projektvendimit, përcaktohet se kohëzgjatja e komandimit, që është deri në pesë vjet. Ndërsa në pikën 7 të tij, përcaktohet mundësia e përfundimit të komandimit përpara afatit të mësipërm, në këto raste: a) me kërkesë të gjyqtarit të komanduar, për shkaqe të justifikuara; b) kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit; c) kur ndaj gjyqtarit të komanduar merret masë disiplinore; ç) kur gjyqtarit të komanduar i mbaron statusi i magjistratit.

Në vijim, në pikën 8 të projektvendimit listohen kushtet e komandimit, që janë: a) Komandimi nuk duhet të bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit; b) Kandidati nuk duhet të jetë në një pozicion me mandat të kufizuar; c) Kandidati nuk duhet të jetë i komanduar; ç) Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë: i) duhet të ketë shërbyer jo më pak se pesë vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit; ii) nuk duhet të ketë kaluar kohëzgjatjen maksimale të komandimit prej më shumë se dhjetë vjet gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës; d) Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Pasur parasysh kërkesën e Gjykatës së Lartë, duke pasur në konsideratë natyrën e pozicionit për të cilën kërkohet komandimi i gjyqtarëve, institucioni është shprehur se preferon që kandidatët të plotësojnë disa kriterë specifikë preferenciale, duke u bazuar në një sërë treguesish. Për rrjedhojë, në pikën 9 të projektvendimit përcaktohen kriteret preferenciale të komandimit e më konkretisht: a) Përvoja profesionale dhe specializimi në

fushën administrative, civile ose penale; b) Njohuri të mira në jurisprudencën e gjykatave vendase; c) Njohuri të mira të juridiksionit ndërkombëtar; ç) Rezultate të mira në studime, si dhe performanca në programin e formimit fillestar dhe vazhdues në Shkollën e Magjistraturës; d) Njohuri të mira, të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian; dh) Aftësi të mira për kryerjen dhe dokumentimin e kërkimeve gjithëpërfshirëse ligjore; e) Aftësi të mira të shkrimit dhe të arsyetimit ligjor; ë) Aftësi të shkëlqyera të komunikimit me shkrim dhe me gojë; f) Qenia autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës.

Në pikën 10 të projektvendimit përcaktohet dokumentacioni që do të shërbejë për vlerësimin nga Këshilli të kushteve të kandidimit, duke parashikuar që Këshilli mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, si dhe në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit të administruar pranë Këshillit.

Në pikën 11 të projektvendimit, përcaktohet procedura e komandimit. Kështu, fillimisht, nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, brenda dy javëve pas përfundimit të afatit të kandidimit, bëhet verifikimi dhe vlerësimi i plotësimit të kushteve të komandimit nga kandidatët që do të aplikojnë. Në këtë rast, Komisioni përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat, në lidhje me qenien e komandimit në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin, projekt-opinione këto që më pas shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinione të miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Në këtë pikë të projektvendimit përcaktohet se Këshilli vendos përjashtimin e kandidatit nga komandimi kur komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin ose kur verifikohet që kandidati nuk plotëson ndonjë prej kushteve të tjera të komandimit.

Sipas parashikimit të bërë në pikën 12 të projektvendimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor i përcjell menjëherë për vlerësim Gjykatës së Lartë emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e komandimit për pozicionin e ndihmësmagjistratit, dokumentacionin e paraqitur nga ata në lidhje me kriteret preferenciale të komandimit, si dhe të dhënat mbi përvojën profesionale të tyre.

Në pikën 13 të projektvendimit, përcaktohet vijimi i procedurës së komandimit, ku Gjykata e Lartë, pasi vlerëson aplikimet e kandidatëve sa i përket kritereve preferenciale, i kërkon Këshillit të Lartë Gjyqësor komandimin e magjistratit që ka përzgjedhur.

Më tej, sipas pikës 14 të projektvendimit, brenda dy javëve nga marrja e kërkesës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos për komandimin në pozicionin e ndihmësmagjistratit, të kandidatit të përzgjedhur nga Gjykata e Lartë.

Ndërkohë, në pikën e fundit të projektvendimit, pikën 15, rregullohet situata ligjore kur asnjë prej kandidatëve nuk plotëson kushtet e komandimit apo kur asnjë prej tyre nuk përzgjidhet dhe kërkohet të komandohet nga Gjykata e Lartë. Në këtë rast, pas njoftimit të Gjykatës së Lartë dhe mbi kërkesën e saj, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rishpallë kërkesën për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për pozicionin e “ndihmësmagjistratit” në Gjykatën e Lartë.

Së fundi, në projektvendim parashikohet hyrja në fuqi menjëherë e tij dhe botimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje, komente apo sugjerime mbi relacionin e shqyrtuar nga zoto Toska, ndaj zoti Qoku hedh në votim projektvendimin e propozuar dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Maksim Qoku është dakord.

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi projektvendimin “Për hapjen e procedurës së komandimit në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë dhe shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.07.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për rikthimin në detyrë të znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|------------------------------------|---------------------------------|
| <i>11. Maksim Qoku</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>12. Medi Bici</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>13. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>14. Brunilda Kadi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>15. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>16. Ilir Toska</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>17. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>18. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>19. Erjon Muharremaj</i> | <i>(anëtar)</i> |

20. Marçela Shehu

(anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zonja Naureda Llagami**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 3. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).**
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).**

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për rikthimin në detyrë të znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zonja Marçela Shehu.

Merr fjalën zonja Marçela Shehu e cila lexon relacionin shpjegues, lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për shqyrtimin e kërkesës për rikthimin në detyrë të znj. {...}”. Lexohet relacioni me përmbajtjen e mëposhtme:

“Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, janë depozituar më datë 22.02.2019, 18.05.2020 dhe 05.06.2020, kërkesat nga znj. {...}, me anë të së cilave ka kërkuar të rikthehet në pozicionin e punës së këshilltarit ligjor pranë Gjykatës së Lartë.

Nga kërkesat e paraqitur rezulton se kërkuesja {...}, ka qenë me detyrë ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, nga data 06.04.2014 deri në datën 14.10.2017 (mbi tre vjet në këtë pozicion), kur është larguar nga detyra me urdhër të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, duke u ndërprerë marrëdhëniet e punës.

Nga informacioni i ardhur nga Gjykata e Lartë, rezulton se znj. {...}, më datë 07.04.2014, me propozim të ish-anëtarit të Gjykatës së Lartë, z. {...}, është emëruar ndihmëse ligjore pranë anëtarit të Gjykatës së Lartë, z. {...}, me kontratë pune me afat të caktuar për 1 (një) vit.

Më datë 07.04.2015, midis znj. {...} dhe Gjykatës së Lartë, është lidhur kontratë pune me afat të caktuar deri më datën e përfundimit të mandatit të gjyqtarit me të cilën punonte si ndihmëse ligjore.

Znj. {...} më datë 14.10.2017, është liruar nga detyra e ndihmëses ligjore me mbarimin e mandatit të anëtarit të Gjykatës së Lartë, z. {...}.

Në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar, si dhe Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kërkuesja ka pasur ende pozicionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Për rrjedhojë, ajo ka plotësuar detyrimet ligjore që impononte ligji nr. 84/2016.

Në datë 22.02.2019, znj. {...} i është drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor duke kërkuar rikthimin e saj në pozicionin e punës si Këshilltare Ligjore pranë Gjykatës së Lartë, referuar nenit 84, pika 4, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe nenit 165, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Gjithashtu rezulton se znj. {...} ka paraqitur dhe një padi, për zgjidhjen e kësaj çështje gjyqësisht pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga informacioni i marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezultoi se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ndodhet në proces gjykimi kërkesë padia e paditëses {...}, me objekt:

- Kthimin e Paditëses {...} në detyrën e Këshilltarit Ligjor në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë.

- Detyrimin e palës së paditur, Gjykata e Lartë për pagimin e pagës për periudhën 14.10.2017 deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

- Detyrimin e palës së paditur, Gjykata e Lartë, për pagimin e shpenzimeve gjyqësore përfshirë pagesën për një avokat.

Rezulton se në këtë proces, Këshilli i Lartë Gjyqësor është i thirrur në cilësinë e palës së tretë.

Propozimi i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës

Duke konsideruar faktin që kërkimi që është parashtruar në kërkesën drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, është aktualisht për shqyrtim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, vlerëson se duhet të pezullohet shqyrtimi i çështjes para Këshillit të Lartë Gjyqësor, në kushtet kur e njëjta çështje është në gjykim nga gjykata, në referim dhe të parashikimit procedural civil sipas të cilit asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata.

Në këto kushte, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Të pezullojë shqyrtimin e kërkesave të paraqitura nga kërkuesja {...}, për rikthimin e saj në funksionin e Këshilltarit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë për shkak se kërkesa është për shqyrtim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje, komente apo sugjerime mbi relacionin e shqyrtuar nga zonja Shehu, ndaj zoti Qoku hedh në votim projektvendimin e propozuar dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Maksim Qoku është dakord.

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi projektvendimin “Për shqyrtimin e kërkesës për rikthimin në detyrë të znj. {...}”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke vendosur: 1. Pezullimin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga znj. {...}, për rikthimin e saj në funksionin e Këshilltarit të Gjykatës së Lartë për shkak se kërkesa është në shqyrtim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. 2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, bashkë me vendimin përfundimtar. 3. Një kopje e këtij vendimi t’i njoftohet znj. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË

LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.07.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i relacionit “Mbi situatën e pritshme të caktimit në pozicion të të sapodiplomuarve për magistratë, profili gjyqtar”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 2. Medi Bici | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ilir Toska | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 9. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zonja Naureda Llagami**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 3. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).**
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).**

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i relacionit “Mbi situatën e pritshme të caktimit në pozicion të të sapodiplomuarve për magjistratë, profili gjyqtar”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues, lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Mbi situatën e pritshme të caktimit në pozicion të të sapodiplomuarve për magjistratë, profili gjyqtar”. Lexohet relacioni me përmbajtjen e mëposhtme:

“Me shkresën nr.459 prot., datë 09.07.2020, Shkolla e Magjistraturës, sikurse kërkon neni 34, i Ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), i ka dërguar Këshillit të Lartë Gjyqësor listën e kandidatëve të diplomuar për magjistratë, profili gjyqtar, në përfundim të vitit akademik 2019-2020.

Në fakt, Shkolla e Magjistraturës ka dërguar dy lista të të diplomuarve për magjistratë, kandidatë për gjyqtarë.

Njëra listë është ajo për “Klasifikimin e kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që kanë mbaruar vitin e dytë në Shkollën e Magistraturës, viti akademik 2019-2020”, cilësuar si “kandidatë për magistratë, subjektet “ex officio”, miratuar me Vendimin nr.16, datë 29.06.2020, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magistraturës.

Ndërsa lista tjetër është ajo për “Klasifikimin e kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që kanë mbaruar vitin e tretë në Shkollën e Magistraturës, viti akademik 2019-2020”, miratuar me Vendimin nr.17, datë 29.06.2020, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magistraturës.

Në këtë vit akademik, si rast përjashtimor, për shkak të ligjit, ka dy kategori të kandidatëve për gjyqtarë, të diplomuar magistratë.

Njëra kategori përfshin ata kandidatë, të cilët:

a) janë rekrutuar si kandidatë për gjyqtarë, sipas mënyrës bazë të përcaktuar nga ligji dhe konkretisht Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), nëpërmjet provimit të pranimit në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magistraturës;

b) kanë ndjekur formimin fillestar për magistratë në Shkollën e Magistraturës, për një periudhë trevjeçare, që përfshin:

- i) një vit program teorik;
- ii) një vit program praktik paraprofesionale;
- iii) një vit praktikë profesionale.

Kategoria tjetër përfshin ata kandidatë, të cilët:

a) janë rekrutuar si kandidatë për gjyqtarë, sipas mënyrës përjashtimore të përcaktuar në nenin 165 të Ligjit për Statusin, pra nëpërmjet testimit të aftësive profesionale në Shkollën e Magistraturës, në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, për këshilltarët e gjyqtarëve pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësve ligjorë në gjykatat administrative, si dhe inspektorëve në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, të cilët nuk gëzojnë statusin e gjyqtarit, por që ishin subjekte rivlerësimi “ex officio” sipas pikës 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe

Ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

b) kanë ndjekur programin e trajnimit për magistratë në Shkollën e Magjistraturës, për një periudhë dyvjeçare, që përfshin:

- i) një vit program teorik;
- ii) një vit praktikë profesionale.

Në nenin 34 të Ligjit për Statusin, titulluar “Lista e renditjes së kandidatëve magistratë të diplomuar”, përcaktohet se: “1. Çdo vit, deri në fund muajit qershor, Shkolla e Magjistraturës publikon listën e kandidatëve magistratë, të diplomuar në formimin fillestar gjatë atij viti. 2. Të diplomuarit renditen në listë, bazuar në rezultatet e provimeve gjatë vitit të parë dhe të dytë, provimit përfundimtar, si dhe vlerësimet gjatë praktikës profesionale. 3. Shkolla e Magjistraturës harton dhe publikon kriteret për koeficientët e vlerësimit të praktikës profesionale dhe rezultatet e çdo provimi. 4. Të diplomuarit përfshihen përkatësisht në listën e të diplomuarve për kandidatët gjyqtarë dhe në listën e të diplomuarve për kandidatët prokurorë. Kandidatët magistratë renditen në listën e të diplomuarve në përputhje me pikën 2 të këtij neni”.

Ndërsa në nenin 165 të Ligjit për Statusin, titulluar “Dispozita kalimtare për ndihmësit ligjorë, këshilltarët e gjyqtarëve dhe inspektorët jomagjistratë”, përcaktohet se: “... 5. Ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqtarit, në kuptim të pikës 4, të këtij neni, marrin pjesë në provimin përfundimtar në përmbyllje të vitit të tyre të parë në Shkollën e Magjistraturës. Ata caktohen për praktikë profesionale dhe vlerësohen gjatë saj, në përputhje me nenin 33 të këtij ligji. 6. Në përfundim të trajnimit dyvjeçar, ndihmësi ligjor, inspektori dhe këshilltari i gjyqtarit, në zbatim të pikës 4, të këtij neni, renditen sipas rezultateve të provimit përfundimtar në fund të vitit të parë dhe të vlerësimit etik dhe profesional gjatë praktikës profesionale. Ata përfshihen në listën e renditjes dhe emërohen si magistratë, sipas parashikimeve të këtij ligji, nëse marrin të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme në provimin përfundimtar në fund të vitit të parë, si dhe janë vlerësuar të paktën "mirë" për të gjitha detyrat e dhëna gjatë praktikës profesionale. 7. Shkolla e Magjistraturës miraton rregullat për procedurën dhe

kushtet për pjesëmarrjen në provimin përfundimtar, kurrikulën dhe pjesëmarrjen në kurset e trajnimit. ...”.

Me tej, sipas nenit 35 të Ligjit për Statusin, titulluar “Emërimi i kandidatit magjistrat të diplomuar”, përcaktohet se: “1. I diplomuari emërohet magjistrat nëse plotëson njëkohësisht këto kritere: a) është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës, në formimin fillestar, me të paktën 70 për qind të pikëve maksimale të mundshme; b) është vlerësuar minimalisht "mirë" për të gjitha detyrat e dhëna gjatë stazhit profesional në vitin e tretë të formimit fillestar; ... 3. Kandidati për gjyqtar kërkon të emërohet si gjyqtar nëpërmjet një kërkesë me shkrim drejtuar Këshillit. Në kërkesë përcaktohen, sipas renditjes preferenciale, tri gjykata në të cilat i diplomuari kërkon të emërohet. ... 4. Brenda afatit njëmuajor nga data e publikimit të listës së të diplomuarve, Këshillat:

a) emërojnë magjistrat çdo person që është në listën e të diplomuarve, i cili përmbush kriteret e emërimit, si dhe ka paraqitur kërkesë, në përputhje me parashikimet e pikave 2 dhe 3 të këtij neni;

b) refuzojnë të emërojnë magjistrat çdo person që është në listën e të diplomuarve që ka paraqitur kërkesë, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij neni, por nuk përmbush kriteret e emërimit. ...”.

Ndërkohë, në nenin 39 të Ligjit për Statusin, titulluar “Caktimi në pozicion i magjistratit të emëruar”, përcaktohet se: “1. Brenda muajit qershor të çdo viti, pas përfundimit të procedurave të transferimit paralel dhe ngritjes në detyrë, secili Këshill shpall vendet e lira për të emëruarit. 2. Brenda muajit korrik të çdo viti, secili Këshill publikon vendimet e tij për caktimin e të emëruarve në pozicionet e lira për magjistrat. 3. Caktimi në pozicion i të emëruarit të sapodiplomuar në Shkollën e Magjistraturës është parësor dhe bazohet në: a) renditjen e tyre në listën e të diplomuarve, sipas nenit 34 të këtij ligji; b) përmbushjen e preferencave të deklaruara nga të diplomuarit në formimin fillestar, duke e zbatuar, për aq sa është e mundur, në përputhje me shkronjën "a", pika 3, të këtij neni. ...”.

Referuar përcaktimeve ligjore si më lart, vetëm për këtë vit, janë dy kategori magjistratësh të sapodiplomuar në Shkollën e Magjistraturës, 13 (trembëdhjetë) që kanë përfunduar programin e formimit fillestar trevjeçar dhe 6 (gjashtë) që kanë përfunduar

programin e trajnimit dyvjeçar, të cilët Këshilli i Lartë Gjyqësor, në përfundim të verifikimeve në kryerje e sipër për ata, do të duhet, fillimisht, t'i emërojë dhe, pas shpalljes së pozicioneve të lira për ta, t'i caktojë në pozicion, në gjykatat e shkallës së parë.

Renditja e të sapodiplomuarve nga Shkolla e Magjistraturës në dy lista krijon një situatë problematike sa i përket caktimit të tyre në pozicion pas emërimit, pasi ligji përcakton:

a) shpalljen e vendeve të lira për të emëruarit, pa bërë dallim mes kategorive që ata iu përkasin;

b) përmbushjen e preferencave të të emëruarve, në përputhje me renditjen e tyre në listën e të diplomuarve, duke nënkuptuar kështu ekzistencën e një liste të vetme të tyre.

Kjo situatë mund të shmanget nga pasja e një liste të unifikuar të të sapodiplomuarve për magjistratë, profili gjyqtar. Në gjë e tillë mund të bëhet vetëm nga Shkolla e Magjistraturës, e cila ka për funksion formimin profesional të magjistratëve, ku përfshihen programi i formimit fillestar trevjeçar për kandidatët për magjistratë, por edhe programi i trajnimit dyvjeçar për kandidatët për magjistratë “ex officio”, duke qenë ajo organi përgjegjës për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve, në të dyja këto programe studimi.

Nisur nga sa më lart:

-për t'i paraprirë situatës së pritshme në rastin e caktimit në pozicion të të sapodiplomuarve në Shkollën e Magjistraturës,

-në funksion të zgjidhjes në përputhje me ligjin të kësaj shtate specifike për këtë vit akademik, dhe

-me synimin për të mos pasur asnjë vonesë në kohë për caktimin në pozicion të të sapodiplomuarve,

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor që t'i kërkojë Shkollës së Magjistraturës, si organi kompetent që bën renditjen e kandidatëve për magjistratë, të unifikojë listën e të diplomuarve për magjistratë, profili gjyqtar, për vitin akademik 2019-2020.”

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje, komente apo sugjerime mbi relacionin e shqyrtuar nga zoti Toska, ndaj zoti Qoku hedh në votim propozimin e ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Illir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Maksim Qoku është dakord.

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi propozimin e ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, që KLGJ t'i kërkojë Shkollës së Magjistraturës, si organi kompetent që bën renditjen e kandidatëve për magjistratë, të unifikojë listën e të diplomuarve për magjistratë, profili gjyqtar, për vitin akademik 2019-2020.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.07.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për publikimin e pozicioneve të lira në nivel apeli, për gjyqtarin {...}, që ka të drejtën e caktimit në një pozicion të tillë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|----------------------------|--------------------------|
| 1. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 2. Medi Bici | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ilir Toska | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 9. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zonja Naureda Llagami*.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
- 3. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).*
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për publikimin e pozicioneve të lira në nivel apeli, për gjyqtarin {...}, që ka të drejtën e caktimit në një pozicion të tillë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues, lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për publikimin e pozicioneve të lira në nivel apeli, për gjyqtarin {...}, që ka të drejtën e caktimit në një pozicion të tillë”. Lexohet relacioni me përmbajtjen e mëposhtme:

“Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur dhe i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor projektvendimin “Për publikimin e pozicioneve të lira në nivel apeli, për gjyqtarin {...}, që ka të drejtën e caktimit në një pozicion të tillë”.

Shkaku i përgatitjes dhe propozimit të këtij vendimi është fakti se Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 11.06.2020, konstatoi se z.{...}, me detyrë gjyqtar i Gjykatës së Lartë, i ka përfunduar detyrimi kushtetues, sipas nenit 136, pika 5,

të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, për qëndrimin në detyrë deri në emërimin e pasardhësit. Në këtë rast, në kushtet kur ligji, nenet 61 dhe 62, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i njohin z.{...} të drejtën për t’u caktuar në nivel apeli, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur që ai të ftohet për t’u shprehur nëse do ta ushtronte këtë të drejtë, duke i caktuar për këtë një afat njëjavor.

Me Shkresën nr.3032 prot., datë 01.07.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor njoftoi z.{...} mbi përfundimin e detyrimit të qëndrimit në detyrë si gjyqtar i Gjykatës së Lartë, si dhe ftoi atë për të shprehur qëndrimin në lidhje me ushtrimin e të drejtës për t’u caktuar në një pozicion në nivel apeli.

Në përgjigje të njoftimit dhe ftesës së Këshillit, brenda afatit të caktuar, z.{...} depozitoi në Këshill, protokolluar me nr.3150, datë 07.07.2020, njoftimin për ushtrimin e të drejtës për t’u caktuar në nivel apeli. Konkretisht, në këtë njoftim z.{...}, ndër të tjera, është shprehur se: ... në zbatim të neneve 61 dhe 62 të ligjit nr.96/2016 ju njoftoj se në ushtrim të së drejtës sime të njohur shprehimisht dhe posaçërisht nga ligji për të vijuar karrierën gjyqësore në një gjykatë apeli, kërkoj që përkundrejt të drejtës sime të përzgjedhjes të parashikuar qartësisht nga ligji, KLGJ të realizojë detyrimet dhe procedurat përkatëse që i ngarkon posaçërisht ligji, duke filluar me njoftimin formal zyrtar që duhet të më dërgohet nga ky Këshill për efekt të ushtrimit të kësaj të drejte, lidhur me të gjitha pozicionet e lira në gjykatat e apelit tashme të publikuara e të shpallura, sikurse urdhërohet shprehimisht në nenin 61 dhe në fjalinë e parë të pikës 1 të nenit 62 të ligjit nr.96/2016, në lidhje me nenet 42 pika 3, 43 pikat 1 dhe 2 dhe 48 pika 1 të këtij ligji”.

Marrë shkas nga ushtrimi prej z.{...}, të të drejtës për t’u caktuar në nivel apeli, në kushtet kur ligji në mënyrë të shprehur nuk ngarkon specifikisht si vendimmarrës një organ tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor (për shembull Komisionin), në procedurat e realizimit të së drejtës së gjyqtarit për t’u caktuar në nivel apeli, ndërkohë që ende nuk është miratuar rregullorja e brendshme e tij (Këshillit), Komisioni i Zhvillimit të Karrierës konsideroi që është Këshilli organi vendimmarrës edhe për publikimin e

pozicioneve të lira në nivel apeli, për gjyqtarin {...}, që ka të drejtën e caktimit në një pozicion të tillë.

Sa i përket pozicionit të lirë në nivel apeli ku mund të caktohet gjyqtari që ka këtë të drejtë, në pikën 1, të nenit 62, Ligji për Statusin parashikon: “Në fund të mandatit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, ... ose në raste të tjera, ku ligji parashikon të drejtën për t’u caktuar në një pozicion në nivel apeli, magjistrati ka të drejtë për t’u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ..., me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion. ...”.

Duket që ligji kërkon publikimin e pozicionit/pozicioneve të lira për gjyqtarët që kanë të drejtën për t’u caktuar në nivel apeli me qëllim që ata të realizojnë të drejtën e zgjedhjes deri në tre, sikurse një gjë e tillë rezulton nga përcaktimi i bërë në pikën 1, të nenit 62 në lidhje me pikat 3 deri në 7, të nenit 60, por edhe nga pika 2, e nenit 62, të Ligjit për Statusin.

Ndërkohë, në dispozita të veçanta të Ligjit për Statusin përcaktohet dhe nocioni i “pozicionit të lirë” në kuptim të këtij ligji.

Konkretisht, sipas Ligjit për Statusin, kemi dy lloj pozicioneve të lira, “të përhershme” dhe “të përkohshme”, çka rezulton nga përcaktimet e bëra në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij ligji.

Më tej, “pozicion i lirë i përhershëm” sipas Ligjit për Statusin nënkupton atë pozicion në një gjykatë, për të cilin nuk ka gjyqtar me të drejtën për t’u kthyer (fjalë e dytë e pikës 2, neni 42), domethënë atë pozicion në të cilin nuk ka gjyqtar të caktuar në mënyrë të përhershme ose atë pozicion (në një gjykatë të shkallës së parë ose të apelit) kur gjyqtarit që e ka pasur atë në mënyrë të përhershme, i ka mbaruar statusin, ose është caktuar, transferuar ose ngritur në detyrë në një pozicion tjetër të përhershëm (pika 5, neni 59).

Ndërsa “pozicion i lirë i përkohshëm” sipas Ligjit për Statusin nënkupton atë pozicion në një gjykatë, kur gjyqtari që e ka atë në mënyrë të përhershme është në pamundësi për të ushtruar funksionin për të paktën 3 muaj, por ka të drejtën për t’u kthyer (fjalë e tretë e pikës 2, neni 42).

Për rastin në shqyrtim, në vlerësim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, ka rëndësi “pozicioni i lirë i përhershëm”, pasi gjyqtari me të drejtën për t’u caktuar në nivel apeli, caktohet në mënyrë të përhershme. Nenet 61 dhe 62 të Ligji për Statusin nuk parashikojnë caktimin e përkohshëm të tij.

Lidhur me realizimin e të drejtës për t’u caktuar në nivel apeli, sikurse më lart u parashtrua, ligji parashikon caktimin e gjyqtarit në pozicionin e parë që publikohet i lirë, ndërkohë që ai ka të drejtën deri në tre zgjedhje.

Lidhur me pozicionet e lira në nivel apeli, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës sjell në vëmendje të Këshillit se aktualisht janë dy kategori pozicionesh të lira dhe konkretisht:

- 1) Pozicione që kanë qenë të lira përpara datës 11.06.2020 dhe për të cilët Këshilli ka filluar procedurat e plotësimit të tyre përmes ngritjes në detyrë ;
- 2) Pozicione që janë bërë të lira mbas datës 11.06.2020 dhe për të cilët Këshilli nuk ka filluar procedurat e plotësimit të tyre .

Çështja e parë dhe më e rëndësishme që Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të vendosë është përcaktimi i pozicioneve të lira në nivel apeli që duhet të publikohen për gjyqtarin {...}, në funksion të realizimit të të drejtës së tij për t’u caktuar në një pozicion të tillë. Pra, nëse si të tilla duhet të publikohen pozicionet e lira të të dy kategorive (1 dhe 2) apo vetëm ato për të cilat të cilat Këshilli nuk ka filluar procedurat e plotësimit të tyre (2).

Lidhur me këtë, në vlerësim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli duhet të mbajë në konsideratë përcaktimin e Ligjit për Statusin në lidhje me plotësimin e pozicionit të lirë të përhershëm, pikërisht atë të pikës 3, të nenit 42, ku parashikohet radha që ndiqet për plotësimin e tij. Konkretisht, sipas kësaj dispozite: “Një pozicion i lirë i përhershëm plotësohet me radhë si më poshtë: a) nga magjistrati që ka të drejtën për t’u caktuar në një pozicion në nivel apeli; b) nga magjistrati që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të gjykatave ...; c) nga magjistrati që transferohet për shkak të lëvizjes paralele; ç) nga magjistrati që ka të drejtën e ngritjes në detyrë”.

Çështjet që shtrohen janë:

a) A kondicionohet e drejta e gjyqtarit për t'u caktuar në nivel apeli me momentin e lindjes së kësaj të drejte?

b) Lindja e të drejtës së një gjyqtari për t'u caktuar në nivel apeli a përbën shkak për ndërprerjen/anulimin e procedurave të plotësimit të një pozicioni të lirë në proces sipas radhëve të mëpasshme?

Në varësi, të përgjigjeve për këto pyetje, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson Këshilli do të mund të përcaktojë pozicionet e lira në nivel apeli që duhet të publikohen për gjyqtarin {...}, në funksion të realizimit të të drejtës ligjore të tij për t'u caktuar në një pozicion të tillë.

Sa i përket strukturës së projektvendimit, ai përbëhet nga 2 pika.

Pika e parë e projektvendimit bën fjalë për publikimin e pozicioneve të lira në nivel apeli, për gjyqtarin {...}, që ka të drejtën e caktimit në një pozicion të tillë, duke lënë të papërcaktuara këto pozicione në varësi të qëndrimit të Këshillit në lidhje me to.

Pika 2 e projektvendimit përcakton se gjyqtari {...} ftohet për të zgjedhur njërin nga pozicionet e lira në nivel apeli sipas pikës 1, brenda __ ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të këtij vendimi, duke lënë të papërcaktuar afatin konkret, kjo në vlerësim të Këshillit.

Së fundi, projektvendimi përcakton hyrjen në fuqi menjëherë të tij, si dhe publikimin e vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.”

Diskutime/Komente/Pyetje/Propozime mbi çështjen

Fillimisht merr fjalën ***zoti Alban Toro*** i cili jep opinionin e tij duke parashtruar si më poshtë: “a) A kondicionohet e drejta e gjyqtarit për t'u caktuar në nivel apeli me momentin e lindjes së kësaj të drejte? b) Lindja e të drejtës së një gjyqtari për t'u caktuar në nivel apeli a përbën shkak për ndërprerjen/anulimin e procedurave të plotësimit të një pozicioni të lirë në proces sipas radhëve të mëpasshme?

Natyrisht që e drejta e gjyqtarit kondicionohet për t'u caktuar në nivel apeli në momentin që Këshilli më parë ka nisur/shpallur procedurat e ngritjes në detyrë duke përcaktuar më parë pozicionet e lira të përhershme dhe ftuar gjyqtarët në konkurrim dhe shprehje interesi. Një veprim i kundërt do të binte ndesh me disa parime të rëndësishme

të sanksionuara edhe në Kushtetutë, të cilat synojnë të sigurojnë pavarësinë e gjyqtarit apo sigurinë juridike.

Neni 138 dhe 145/1 të Kushtetutës si edhe nder të tjera edhe neni 57 pika 4 e Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” garanton dhe sanksionon pavarësinë e jashtme dhe e brendshme e pushteti gjyqësor, (pavarësia nga pushtetet e tjera dhe pavarësia gjyqësore individuale pasi gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve shih vendimin nr. 40, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese).

Edhe në këtë aspekt po kufizohem në lidhje me pavarësinë individuale e cila ka rëndësi për kthimin e përgjigjes “A”. Kjo pavarësi sigurohet ndër të tjera edhe me procedurat e emërimit, e promovimit të gjyqtarëve bazuar mbi kualifikimin profesional dhe integritetit personal apo edhe të detyrimit të ruajtjes së pozicionit të punës gjatë kohës që ata janë në periudhën e komandimit. Kjo procedurë promovimi rregullohet në mënyrë të detajuar nga neni 43, 47, 48 dhe 57 e tjerë të Ligjit për Statusit. Në analizën tonë po fokusohem në një nga dispozitat e mësipërme dhe konkretisht nenit 48 i Ligjit për Statusin.

Kuptimi dhe rëndësia e sistemit të garancive që lidhen me statusin e gjyqtarit është analizuar edhe më parë nga jurisprudenca kushtetuese duke theksuar në këtë rast rëndësinë që ka ky sistem në kuadër të pavarësisë së gjyqtarit. Garancitë e sanksionuara nga dispozitat kushtetuese u njohin gjyqtarëve një trajtim specifik jo vetëm në pagë por edhe në qëndrueshmërinë ruajtjen e pozicionit të funksionit apo elemente të tjera që burojnë nga ushtrimi i saj si edhe në mënyrë të veçantë ngritja në detyrë e tyre. Statusi i gjyqtarëve dhe garancitë që ato ofrojnë synojnë sigurimin e kompetencës, pavarësisë dhe paanësisë të tyre, elemente këto që çdo individ i pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga çdo gjyqtar, të cilit i është besuar mbrojtja e të drejtave të individëve. Të njëjtën mbrojtje, dispozita i siguron edhe konkurrimit për të cilat janë parashikuar procedura të detajuara për shpalljen, mënyrën e konkurrimit, kriteret e vlerësimit duke siguruar për ta një “*par condicio*” dhe një procedure transparente konkurrimi.

Pikërisht kjo analizë nuk lejon që pritshmëria e gjyqtarëve nga konkurrimi i shpallur tashmë nga KLGJ të ndërpritet pasi ata kanë filluar konkurrimin me argumentin

e interpretimit të pikës 3, të nenit 42 të Ligjit për Statusin. Ky i fundit ka prioritet në rastin kur pozicione që janë bërë të lira mbas datës 11.06.2020 dhe për të cilët Këshilli nuk ka filluar procedurat e plotësimit të tyre dhe në këtë kuadër ai shpall pozicione të dedikuara vetëm në funksion të kandidatit të cilit i ka lindur e drejta për t'u caktuar në pozicion në nivel apeli. Shmangia e konkurrimit për shkak të pozicionit të dedikuar krijohet vetëm në funksion të aplikimit të pikës 1, të nenit 62, Ligji për Statusin parashikon: “Në fund të mandatit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, ... ose në raste të tjera, ku ligji parashikon të drejtën për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli, magjistrati ka të drejtë për t'u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ..., me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion. ...”.

Lutem tërheqë vëmendjen tuaj në shprehjen “magjistrati ka të drejtë për t'u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel apeli..”. Ligji material, përfshirë edhe kjo dispozitave, përmban tërësinë e rregullave që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e individëve, personave juridikë dhe imponon sjelljen në një marrëdhënie juridike. Zbatimi i ligjit material lidhet me momentin kur ka lindur e drejta. Edhe nga interpretimi i këtij neni rezulton qartë se lindja e se drejtës krijohet në momentin e formalizimit të shprehjes se interesit nga gjyqtari. Në këtë kontekst Këshilli shpall më pas pozicionet e “dedikuara” dhe në opinionin tim ka shumë rëndësi ky fakt pasi Këshilli duhet të evitojë konkurrimin e gjyqtarëve të tjerë.

Çdo interpretim i kundërt cenon nder të tjera edhe elementët e sigurisë juridike. Një e tillë është edhe mbrojtja e pritshmërive të ligjshme nga rendi juridik e cila ka të bëjë me të drejtën që kanë individët, në rastin konkret gjyqtarët në konkurrim për të gëzuar pasojat e pritshme të rendit juridik në fuqi, në kohën kur ata ushtrojnë të drejtat e tyre të ligjshme për t'u ngritur nëse detyrë. Për më tepër, kur këtyre personave i vijnë pasoja të pafavorshme nga ndryshimi i sjelljes së Autoritetit Publik i cili prodhon akte administrative me efekt prapaveprues duke anuluar procedura tashme të konkurrimit dhe të renditjes. Parimi i përgjithshëm është se masat me efekte të pafavorshme dhe njëkohësisht prapavepruese janë të ndaluara dhe përjashtimet mund të parashikohen vetëm në rastet kur synohen të mbrohen interesa publike më të lartë dhe në raste të përcaktuara qartë nga ligjvënësi.

Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese në lidhje me ligjvënësin është shprehur se: “ ..ligjvënësi duhet të mbajë parasysh se një situatë të rregulluar më parë, parimisht mund ta ndryshojë vetëm nëse kjo sjell pasojë pozitive për subjektet përfituese dhe jo kur ndryshimi i akteve e përkeqëson situatën, pra i heq subjekteve fituese një të drejtë të fituar më parë.....” (Shih vendimin nr.2/2013; vendimin nr.9/2007 të Gjykatës Kushtetuese).

E fundit mosmarrja në konsideratë e renditjes së kandidatëve do të dëmtojë në mënyrë të përhershme konkurrimin e tyre në rast se ata kanë bërë tashmë tre përzgjedhje, parashikuar kjo nga neni 48 pika 6. Në të ardhmen ai nuk ka të drejtë të bëjë përzgjedhje të tjera, pasi me ezaurimin e tyre, ligji ndalon konkurrime të tjera.

Edhe nga pikëpamja morale është e papranueshme dhe e fajshme që të ndërpritet konkurrimi në fazat ku ndodhet dhe një nga pozicionet e shpallura të lira t’i akordohet kërkuesit. Në fund të fundit për fajin moral, instanca më e lartë e drejtësisë mbetet ndërgjegjja e gjithsecilit.

Për të gjithë këto arsye Këshilli duhet të ofroje pozicion të lirë të përhershme të shpallura pas shprehjes së interesit dhe në këtë aspekt, vakancat në Gjykatën e Posaçme të Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar mund të ezaurojnë në mënyrë shteruese detyrimin tonë për sistemimin e z. {...} si edhe plotësimin e vakancës në një nga gjykatat më të rëndësishme të sistemit gjyqësor.”

Gjithashtu edhe **zoti Medi Bici** për çështjen në fjalë thekson se gjyqtari {...} është emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë me dekretin e Presidentit të Republikës nr.4481, datë 17.02.2005, ndërkohë që Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Vendimin nr.175, datë 24.02.2005, ka dhënë pëlqimin për emërimin e tij në detyrën e anëtarit të Gjykatës së Lartë. Mandati i tij ka qenë për një periudhë 9-vjeçare, bazuar në nenin 136 të Kushtetutës, pa të drejtë riemërimi. Bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 8588, datë 15.03.2000 mandati i tij 9-vjeçar ka përfunduar më datë 24.02.2014.

Gjithashtu z. Bici theksoi se për sa i përket pozicionit të lirë në nivel apeli ku mund të caktohet gjyqtari që ka këtë të drejtë, në nenin 62, të ligjit për Statusin parashikohet se: “Në fund të mandatit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, ... ose në raste të tjera, ku ligji

*parashikon të drejtën për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli, **magjistrati ka të drejtë për t'u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel apeli, përkatësisht në gjykata ..., me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion. ...**”.*

Ndërkohë vlerësoi që e drejta e zgjedhjes për z. {...} **ka lindur që në datën 11.3.2020**, ditën në të cilën dekretet e Presidentit të Republikës për emërimin e gjyqtarëve të rinj, dita kur u formua një trup gjykues prej tre gjyqtarësh në Gjykatën e Lartë dhe kur z. {...} ka përmbushur detyrimin e tij kushtetues për të qëndruar në detyrë, për të garantuar vazhdimësinë institucionale dhe funksionale të Gjykatës së Lartë.

Mbështetur në sa më sipër z. Bici mban qëndrimin e publikimit të të gjitha pozicioneve të lira në nivel apeli, për të cilat zoti {...} të ftohet të përzgjedh njërin nga këto pozicione, kjo pasi vlerëson që zgjedhja e një gjyqtari të Gjykatës së Lartë prevalon mbi ngritjen në detyrë.

Në vijim edhe **zoti Erjon Muharremaj** jep opinionin e tij duke parashtruar si më poshtë: “Në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 68, pika 7, të ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, deklaroj arsyet e votimit, sa i përket çështjes së publikimit të pozicioneve të lira dhe ftesës për të zgjedhur njërin nga pozicionet e lira në nivel apeli, për z. {...}.

Në nenin 62, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se në fund të mandatit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, magjistrati ka të drejtën për t'u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel apeli, me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion.

Në nenin 42, pika 3, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet radha që ndiqet për plotësimin e një pozicioni të lirë të përhershëm: “Një pozicion i lirë i përhershëm plotësohet me radhë si më poshtë: a) nga magjistrati që ka të drejtën për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli; b) nga magjistrati që transferohet për shkak të papajtueshmërisë ambientale ose për shkak të ndryshimeve në strukturën administrative ose në kompetencën tokësore të

gjykatave ...; c) nga magistrati që transferohet për shkak të lëvizjes paralele; ç) nga magistrati që ka të drejtën e ngritjes në detyrë”.

Referuar këtyre dispozitave, kur për të njëjtat pozicione të lira të përhershme konkurrojnë kandidatë që kanë të drejtën për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli dhe kandidatë që kanë të drejtën e ngritjes në detyrë, përparësi kanë kandidatët që kanë të drejtën për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli. Ky është edhe qëllimi që legjislatori në nenin 62, pika 1, të Ligjit “Për statusin” ka përdorur togfjalëshin “ka të drejtën për t'u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë”, në kuptim të përparësisë që duhet t'i jepet kandidatit që ka të drejtën për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli, në krahasim me kandidatin që ka të drejtën e ngritjes në detyrë, e jo në kuptim të përcaktimit të afatit kohor të hapjes së pozicionit. Nëse do të pranohej kjo e fundit, duke bërë një interpretim literal dhe jo teleologjik të dispozitës, atëherë kandidatit që ka të drejtën për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli do t'i hiqej e drejta e zgjedhjes midis një pozicioni të parë, të dytë, apo të tretë, pasi do të ishte paracaktuar tashmë për të pozicioni i parë. Kjo do e shndërronte në fakt formulimin e dispozitës në “ka vetëm mundësinë për t'u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë”, duke bërë të pavlerë renditjen e kandidatëve sipas përparësisë.

Për më tepër, e drejta e zgjedhjes për z. {...}, si ish-anëtar i Gjykatës së Lartë, përveçse nga formulimi i dispozitave ligjore të sipërcituara, del qartë edhe nga qëllimi i ligjvënësit në hartimin e këtyre normave. Kështu, duke iu referuar relacionit të propozuesve të projektligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (sot ligj), në faqen 5, përcaktohet se “Projektligji parashikon të drejtën e kthimit të magistratit në pozicionin e mëparshëm, duke përcaktuar gjithashtu se në fund të mandatit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, ose si Prokuror i Përgjithshëm, ose në raste të tjera ku ligji parashikon të drejtën për t'u caktuar në një pozicion në shkallë apeli, magistrati ka të drejtën për t'u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, të të njëjtës shkallë, në rast se plotëson kriteret për atë pozicion.”

Gjithashtu, referuar debatit parlamentar në diskutimin e projektligjit, sidomos në diskutimet midis deputetëve dhe ekspertëve të nivelit të lartë të përfshirë në reformën në drejtësi, në lidhje me këtë parashikim, arrihet konkluzioni vijues (diskutimi përmbyllës i

relatores së projektligjit, deputetes znj. {...}, procesverbali i seancës së datës 6.7.2016 i Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë): “Unë e vlerësoj faktin që keni shtuar hierarkinë e disa kritereve për të përcaktuar dhe hierarkinë e vlerave, si dhe radhën e plotësimit ose të caktimit në nivelin e apelit. Kjo është një gjë pozitive me qëllim që të shmangët çdo lloj përdorimi abuziv apo të ndodhë ajo që ka ndodhur sot, që drejtuesja e Gjykatës së Lartë, apo ish-prokurorja e Përgjithshme, janë ende pa punë. Pra, nuk kanë gjetur pozicionin e tyre të punës, sepse pozicionet e tyre janë zënë nga persona që kanë kaluar dhe ata qëndrojnë në listë pritjeje, ose nuk marrin emërimet për një kohë të gjatë, siç është dhe rasti i zonjës {...}. Në praktikën tonë kemi disa raste që personat kanë qenë të detyruar të marrin detyra të rëndësishme në institucionet tona shtetërore dhe më pas kanë ngelur pa punë, siç janë dhe sot. Pra, mua më vjen mirë për shtesën që keni bërë te paragrafi 3. Zoti kryetar, unë nuk kam gjë tjetër për këtë nen.” Pra, nga tërësia e materialeve të mësipërme, del qartë qëllimi i ligjvënësit për t’i dhënë përparësi subjekteve që u ka mbaruar mandati në Gjykatën e Lartë, për të zgjedhur të parët midis pozicioneve të lira në nivel apeli.

Referuar qëndrimin tim në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 11.6.2020, vlerësoj që e drejta e zgjedhjes për z. {...} ka lindur që në datën 11.3.2020, data e dekreteve të Presidentit të Republikës për emërimin e gjyqtarëve të rinj, dita kur u formua një trup gjykues prej tre gjyqtarësh në Gjykatën e Lartë dhe kur z. {...} ka përmbushur detyrimin e tij kushtetues për të qëndruar në detyrë, për të garantuar vazhdimësinë institucionale dhe funksionale të Gjykatës së Lartë. Togfjalëshi “Në fund të mandatit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë... magjistrati ka të drejtë për t’u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel apeli...” duhet të lexohet i lidhur me nenin 136 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që parashikon se “...gjyqtarët e Gjykatës së Lartë...qëndrojnë në detyrë deri në emërimin e pasardhësit.” Pra, në vlerësimin tim, e drejta e z. {...} për t’u caktuar në një pozicion në nivel apeli ka lindur në datën 11.3.2020, dita e emërimit të pasardhësit.

Për sa më sipër, në kushtet kur tashmë Këshilli i Lartë Gjyqësor ka njoftuar z. {...} për ushtrimin e së drejtës së njohur nga ligji për të vijuar karrierën gjyqësore në një

gjykatë apeli, e drejta e tij e përzgjedhjes dhe caktimi i tij në një pozicion apeli, kanë përparësi në krahasim me ngritjen në detyrë të gjyqtarëve të tjerë.

Në këto kushte, vlerësoj që z. {...} t'i komunikohet që ka të drejtën të zgjedhë njërin nga pozicionet që kanë qenë të lira si përpara datës 11.6.2020, për të cilat Këshilli ka filluar procedurat e plotësimit të tyre përmes ngritjes në detyrë, ashtu edhe nga pozicionet që janë shpallur të lira pas asaj date.

Rrjedhimisht, pas zgjedhjes që eventualisht mund të bëhet prej z. {...}, nëse prej tij do të zgjidhet një prej pozicioneve që kanë qenë të lira përpara datës 11.06.2020, në respektim të detyrimit ligjor për radhën që duhet të ndiqet për plotësimin e një pozicioni të lirë të përhershëm, Këshilli duhet të anulojë vendimin e tij dhe procedurën e plotësimit përmes ngritjes në detyrë të vetëm atij pozicioni, ndërsa kandidatët për atë pozicion duhet të presin hapjen e pozicionit të lirë të radhës, nëse nuk janë caktuar ende në ndonjë pozicion tjetër.

Së fundi, duke e vlerësuar si zhvillim pozitiv marrjen në konsideratë të mundësisë së ushtrimit të së drejtës së njohur nga ligji për të vijuar karrierën gjyqësore, besoj dhe shpresoj që qëndrimi publik i z. {...} pasi Këshilli i Lartë Gjyqësor konstatoi përfundimin e detyrimit të tij kushtetues për qëndrimin në detyrën e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, të ketë qenë një reagim momental dhe emocional i tij. Në të kundërt, ky qëndrim do të kishte një ndikim negativ, në kushtet kur gjyqësori po bën përpjekjet maksimale për kthimin e besimit të publikut, Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organ qeverisës, të mos gëzonte besimin e vetë gjyqtarëve.”

Rimerr fjalën *zoti Toro* i cili i drejton një pyetje zotit Erjon Muharremaj duke ndërtuar një kazus të tillë: Nëse sot në rastin hipotetik kandidati për gjyqtar z. Erjon Muharremaj do të ishte renditur i pari gjatë vlerësimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ndërkohë që anëtar i Toro propozon që në vend të tij, Këshilli të dërgojë z. {...} në apel (shembull një pozicion i lirë në apelin e Tiranës), pavarësisht se zoti Muharremaj kishte kandiduar, është renditur i pari, është vlerësuar, ka shprehur interesin dhe në këtë kontekst ligji thotë që atij duhet t'i takojë ky vend. Cili do të ishte mjete që do të përdorte për të kundërshtuar këtë vendimmarrje? Do ta pranonte atë? Është korrekt?

Zoti Muharremaj, në përgjigje shprehet se së pari, nëse zoti Toro e ka ndjekur me kujdes fjalën e tij, zoti Muharremaj iu referua dispozitave të ligjit. Debati parlamentar u bë me qëllim sqarimin e qëllimit të legjislatorit për hartimin e atyre dispozitave. Ndërsa në lidhje me kazusin që u parashtrua nga zoti Toro, zoti Muharremaj shprehet se përgjigjja del e qartë nga diskutimi i bërë prej tij, ku përparësi duhet të ketë caktimi në një pozicion apeli i ish-gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Kështu që zoti Muharremaj nuk do ta kundërshtonte një vendim të tillë sepse vlerëson që caktimi në një pozicion të apelit i gjyqtari të Gjykatës së Lartë ka përparësi ndaj ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të tjerë.

Në vijim të diskutimeve merr fjalën **zonja Marçela Shehu** e cila shprehet se në nenin 42, pika 3 e ligjit për Statusin që u citua edhe nga kolegët, të gjithë e kanë të qartë, për asnjëri nuk e vë në diskutim prioritetin që i jep ligji të drejtës së magjistratit që ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Lartë për t'u caktuar në pozicion në nivel apeli. Sipas zonjës Shehu, i gjithë diskutimi është që ky prioritet do të vihet në diskutim për pozicionet që kanë qenë të lira para lindjes së të drejtës së këtij magjistrati apo për pozicionet që janë bërë të lira pas lindjes së të drejtës së magjistratit (në këtë rast të z. {...}) për t'u caktuar në një gjykatë në nivel apeli.

Cili është momenti i lindjes së kësaj të drejte, -pyet zonja Shehu. Sipas vlerësimit të saj, që momenti i lindjes së të drejtës së zotit {...} është momenti kur Këshilli vlerësoi dhe e shprehu që zotit {...} i ka mbaruar detyrimi kushtetues; e njoftoi zotin {...} lidhur me këtë moment; dhe zoti {...} dha pëlqimin për t'u caktuar në një nivel apeli. Zonja Shehu me këtë moment e lidh lindjen e së drejtës së zotit {...} apo cilido magjistrati (nuk ka lidhje me emrin nominal të zotit {...}), ky është momenti i lindjes së të drejtës së zotit {...} për t'u caktuar në një pozicion në nivel apeli dhe në këtë moment fillon edhe detyrimi i Këshillit për të respektuar dhe zbatuar si duhet nenin 42, pika 3 të ligjit për Statusin.

Pra, sipas zonjës Shehu, të gjitha ato vende të lira që janë bërë të lira pas momentit të lindjes së të drejtës së zotit {...}, prioritet do t'i jepet z. {...}, referencave të tij, dhe më pas do të kalohet tek pikat e tjera që parashikon ligji.

Zonja Shehu vijon, se përveçse ligjore, i gjithë diskutimi duket i drejtë dhe shumë i moralshëm, në lidhje edhe me të gjithë gjyqtarët dhe magjistratët e tjerë që kanë kandiduar, kanë shprehur vullnetin, kanë hyrë në një garë, procedura ka ecur dhe Këshilli është në një fazë të caktuar të procedurave të ngritjes në detyrë, procedurë e cila tani mund të ishte edhe e finalizuar. Asgjë nuk e ndalte Këshillin që në një procedurë normale kjo procedurë të ishte finalizuar, pra ku të kishte sot gjyqtarë të ngritur në detyrë, të caktuar në nivel apeli. Ndaj, zonja Shehu vlerëson që përveçse është ligjore ky qëndrim është edhe një qëndrim i drejtë, logjik dhe nuk cenon parimin e sigurisë juridike që duhet të kenë magjistratët.

Vijon me fjalën e saj *zonja Brikena Ukperaj* e cila diskutimin e saj e nis me interpretimin e nenit 62, pika 1 të ligjit për Statusin duke cituar atë pjesë të nenit që vlerëson se ka rëndësi për diskutimin e çështjes së sotshme - “E drejta e magjistratit për t’u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë”. Duke marrë parasysh që kanë ndodhur edhe disa përkthime të ligjit nga versionin anglisht, ku zonja Ukperaj është konsultuar edhe me versionin anglisht të dispozitës, pavarësisht se fuqi juridike ka pikërisht versionin e publikuar në fletoren zyrtare, termi “publikohet” duhet të interpretohet me bërjen e pozicionit të lirë, domethënë publikimi në fakt nuk është diskrecion, publikimi është informacion për të tretët dhe për gjyqtarin se cilat janë vendet e lira, por duke qene se ligjvënësi përdor termin “publikohet”, do të thotë që i referohet një të ardhmeje dhe jo një të shkuare.

Në vlerësim të zonjës Ukperaj, neni 62, pika 1, duhet të interpretohet në mënyrë të tillë që, magjistrati ka të drejtën për t’u caktuar në një vend apeli, duke zgjedhur midis vendeve të lira që bëhen të tilla ose që janë të tilla në momentin e mbarimit të mandatit apo mbarimit të detyrimit të qëndrimit në detyrë. Në këtë rast, ka dy momente të ndryshme, momenti i mbarimit të mandatit dhe momenti i mbarimit të qëndrimit në detyrë.

Më tej zonja Ukperaj shprehet se lindja e së drejtës për zotin {...}, nuk ka ardhur në momentin e mbarimit të mandatit, por ka ndodhur në momentin e mbarimit të detyrimit për qëndrimin në detyrë të tij. Zonja Ukperaj vlerëson se mbarimi i qëndrimit

në detyrë për z. {...}, duke qenë se ka qenë një vendimmarrje e Këshillit, që deri më sot në fakt nuk ka një datë të përcaktuar sepse ka diskutime të ndryshme për momentin se kur i ka mbaruar detyrimi i qëndrimit në detyrë, dhe për t'iu kthyer edhe një herë diskutimeve, sipas zonjës Ukperaj, është data 11 qershor 2020. Pra për të gjitha pozicionet e lira pas datës 11 qershor 2020.

Zonja Ukperaj vlerëson që vendet që të publikohen si të lira, duke përdorur termin “publikim”, pasi publikimi nuk është diskrecion, nuk mund të vendosë Këshilli se cilat vende duhet të publikohen, por duhet thjesht të publikohen ato që janë pozicione të lira dhe këto pozicione të lira, duhet të jenë ato që janë bërë të tilla pas datës 11 qershor 2020, kur Këshilli ka marrë vendim për përfundimin e detyrimit të qëndrimit në detyrë dhe është njoftuar zoti {...} për ushtrimin e të drejtës së zgjedhjes. E drejta e zgjedhjes i ka lindur në këtë moment, pastaj momenti i dytë se kur zoti {...} do ta ushtronte, kjo lidhet me njoftimin.

Prandaj, zonja Ukperaj vlerëson që të gjitha vendet që janë bërë të lira mbas datës 11 qershor, pavarësisht se për to ka filluar apo jo një procedurë e ngritjes në detyrë, duhet të jenë vendet e lira që duhet t'i njoftohen zotit {...}, dhe jo të gjitha vendet që ne kemi shpallur ose që janë bërë të lira para datës 11 qershor 2020.

Më tej shton se duke iu referuar relacionit, në fakt janë përmendur disa vende që janë bërë të lira nga ana e Komisionit, por është anashkaluar edhe një fakt ose jo (ndoshta nuk është anashkalim), por që ka të bëjë me një pozicion të lirë në Gjykatën e Apelit Administrativ, që është bërë i lirë në fakt në fund të qershorit të vitit 2020 (pozicion i cili ka të bëjë me mbarimin e statusit të gjyqtarit {...}). Për këtë pozicion të lirë që është bërë i lirë në fakt pas datës 11 qershor, Këshilli ka filluar procedurën e ngritjes në detyrë në muajin maj, sepse në atë moment nuk kishte një vendimmarrje dhe nuk kishte ende një gjyqtar që kishte të drejtën për t'u caktuar në nivel apeli.

Duke iu bashkuar qëndrimit të zotit Muharremaj dhe z. Bici lidhur me prioritetin që ka e drejta e zgjedhjes nga ngritja në detyrë sepse në vlerësimin e zonjës Ukperaj, pozicionet e lira që duhet të publikohen për zotin {...}, duhet të jenë të gjitha pozicionet të bëra të lira ose që janë të lira mbas datës 11 qershor, duke përfshirë edhe pozicionin e

Gjykatës së Apelit Administrativ, pavarësisht se për të është shpallur procedura e ngritjes në detyrë.

Ndërsa lidhur me arsyetimin e bërë nga zoti Toro, zonja Ukperaj vlerëson që është një arsyetim shumë i drejtë dhe praktika e sjellë prej tij gjithashtu është në mbështetje të arsyetimit, por ajo shprehet se në rastin konkret e drejta e zgjedhjes së gjyqtarit predominon mbi procedurën e ngritjes në detyrë, se në të kundërt nuk do të kishte “zgjedhje” por do të kishte “caktim”, duke vijuar që vendimmarrja e sotshme do të shërbejë edhe si një standard për të ardhmen.

Diskutimet vijnë me *zotin Dritan Hallunaj* i cili shprehet se Këshilli duhet të ketë parasysh se çfarë ka ndodhur me praktikën e mëparshme në raste të tilla, që do të thotë që prokurorët e përgjithshëm, me mbarimin e mandatit janë lënë rrugëve, janë lënë pa punë, janë lënë duke gjetur artifica të ndryshme, vendimmarrje të cilat zoti Hallunaj ka qenë pjesë, duke u shprehur në vendim mbi detyrimin e Këshillit për rikthimin në një pozicion apeli për të gjithë këta persona. Kjo ishte pjesa që u bë detyrim, në kuadër të reformës në drejtësi, në kuadër të ndryshimeve ligjore, u ndryshuan shumë pika, duke u futur/specifikuar edhe ajo që thotë neni 62 i ligjit për Statusin. Po të lexohet neni 62, pika 1 e cila fillon “Në fund të mandatit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, ... , ku ligji parashikon të drejtën për t’u caktuar në një pozicion në nivel apeli, magjistrati ka të drejtë për t’u caktuar në pozicionin e parë që publikohet i lirë, në nivel apeli, ..., me kusht që të plotësojë kriteret për atë pozicion. ...”. Ky është detyrimi, pra që t’i ofrohet vendi i apelit.

Zoti Hallunaj shprehet se nuk ka qenë prezent në mbledhjen e datës 11 qershor 2020 për arsye shëndetësore, por bie dakord me atë që tha zonja Ukperaj, që vendet që duhet t’i ofrohen të jenë vendet që janë të lira pas datës 11 qershor sepse deri në atë ditë ai ka pasur statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe si i tillë, duke i dhënë përparësi kësaj kategorie, zoti Hallunaj propozon që t’i ofrohen të gjitha pozicionet e lira, duke përfshirë këtu edhe pozicionin e lirë të Gjykatës Administrative për faktin që, pavarësisht se për këtë pozicion kanë filluar procedurat, prevalon e drejta e një anëtari të Gjykatës së Lartë që të zgjedhë, për shkak të kontributit të madh të dhënë në Gjykatën e Lartë

(gjykatë karriere), pra prevalon kjo, që Këshilli t'i ofrojë të gjitha vendet e lira të krijuara nga data 11 qershor 2020, duke përfshirë edhe apelin administrativ.

Zoti Bici rimerr fjalën për të plotësuar fjalën e tij, në ndryshim nga mendimi i zonjës Ukperaj dhe zotit Hallunaj, zoti Bici dhe zoti Muharremaj i qëndrojnë mendimit që Këshilli duhet ta bënte mbledhjen më përpara dhe menjëherë pas daljes së dekretit të Presidentit më datë 11 mars, Këshilli duhet ta njoftonte gjyqtarin (siç veprroi më datë 11 qershor). Kështu që, e drejta e zotit {...} për t'u emëruar në një pozicion apeli i ka lindur ditën që i ka dalë dekreti i Presidentit, jo ditën që ka bërë mbledhjen Këshilli, pasi Këshilli mund ta bënte mbledhjen edhe pas 2 vjetësh.

Zoti Muharremaj rimerr fjalën i cili bie dakord me zotin Bici, duke iu referuar sërish pikës 1 të nenit 62 të ligjit për Statusin i cili thotë: “Në fund të mandatit si gjyqtar në Gjykatën e Lartë, ...”, “në fund të mandatit” dhe kjo duhet lexuar së bashku me detyrimin kushtetues që gjyqtari të presë pasardhësin e tij. Kështu që, kjo dispozitë duhet interpretuar që në kohën kur përmbushet detyrimi i tij kushtetues për të pritur pasardhësin dhe kjo korrespondon me datën e dekretit të Presidentit të Republikës të datës 11 mars, në gjykimin e zotit Muharremaj, ky është momenti që gjyqtarit i lind e drejta për të zgjedhur pozicionin e apelit ku do caktohet, pozicione që janë të lira në atë moment.

Edhe zonja **Fatmira Luli** merr fjalën për të dhënë mendimin e saj lidhur me çështjen. Zonja Luli gjykon që e drejta e zotit {...} për t'iu ofruar një vend në apel i ka lindur që në momentin që ai është zëvendësuar në funksionin e tij me dekret të Presidentit të Republikës dhe mendoj që, që nga ai moment, atij duhet t'i ofrohen të tëra vendet që janë publikuar të lira, mbas datës që në Gjykatën e Lartë janë dekretuar tre gjyqtarët e parë, për të cilën Këshilli konsideroi që kanë zëvendësuar zotin {...}. Në këto kushte, zonja Luli gjykon që nga ai moment, zotit {...} i ka lindur e drejta për t'u caktuar në nivel apeli dhe vendet që janë publikuar mbas kësaj date, i takon të zgjedhë gjyqtari {...}, për të vazhduar detyrën e tij si magjistrat.

Pas diskutimeve dhe propozimeve të dhëna nga anëtarët e Këshillit për çështjen, si dhe pas diskutimeve të anëtarëve se cili propozim duhet të hidhet në votim i pari, fillimisht hidhet në votim propozimi i parë, i cili konsiston në: Zotit {...} t'i ofrohen të gjitha vendet që janë të shpallura sot për procedurën e ngritjes në detyrë (edhe para datës 11 qershor 2020), rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Brunilda Kadi është kundër me arsyetimin pothuaj të bërë nga zoti Toro fillimisht, që zotit {...} dhe çdo magjistrati tjetër në këtë lloj pozicioni nuk i cenohet asnjë e drejtë dhe nga ana tjetër cenohet parimi i sigurisë juridike dhe të drejtat e magistratëve të tjerë që janë në garë. Zonja Kadi shprehet se nuk bën sens që të ndryshohen rregullat e lojës mbasi kanë hyrë në garë. Për këtë arsye zonja Kadi voton kundër këtë propozimi. Zonja Kadi ka votuar në parim kundër të drejtës së zotit {...} për t'u caktuar në një pozicion apeli duke thënë në atë votim që sipas zonjës Kadi, neni 62 referon për plotësimin e kriterëve dhe kriteret për gjykatat e apeleve në Republikën e Shqipërisë kërkojnë përkatësisht 7 vjet dhe 10 vjet si gjyqtar në shkallë të parë, në atë lëndë ku është hapur edhe pozicioni. Por në kushtet kur Këshilli, me shumicë votash votoi që ai e ka këtë të drejtë, zonja Kadi vijon votimin pas kësaj vendimmarrjeje për pjesën tjetër të procedurës. Kjo ishte për sqarim nga seanca e mëparshme ku është vendosur në parim kjo e drejtë. Përfundimisht, zonja Kadi është kundër propozimit që u hodh në votim.

Dritan Hallunaj është kundër.

Illir Toska është kundër.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është kundër.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është kundër.

Medi Bici është dakord.

Maksim Qoku është dakord.

(6 anëtarë janë kundër dhe 4 anëtarë janë pro.)

Hidhet në votim propozimi i zonjës Ukperaj, propozim i cili konsiston në: Publikimi i të gjitha vendeve vakante që janë bërë të tilla pas datës 11 qershor 2020, pavarësisht nëse për to kanë filluar ose jo procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatën e apelit (pra bëhet fjalë për një vend vakant në Gjykatën e Apelit Administrativ, si dhe disa pozicione të lira për të cilat nuk ka kandidatë që kanë kandiduar dhe lidhur me këtë zoti Toska sqaron se Këshilli ka rishpallur procedurat për 1 pozicion të lirë në Gjykatën Gjirokastrë, Korçë dhe Shkodër dhe ka mbaruar para dy ditësh edhe afati i kandidimit pas rihapjes së këtyre procedura dhe ku nuk ka kandiduar asnjë gjyqtar), dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Brunilda Kadi është kundër me të njëjtin arsyetim që për atë që ka filluar procedura nuk mund të përfshihet në zgjedhje sepse ndryshohen rregullat e lojës pas lojës. Pra është kundër.

Dritan Hallunaj është dakord për të gjitha ofrimin e vendeve nga data 11 qershor 2020, duke përfshirë edhe ato që është filluar procedura e ngritjes në detyrë.

Illir Toska është pjesërisht kundër vetëm sa i përket pozicioneve që janë në procedurë e sipër dhe ka mbaruar afati i kandidimit dhe Këshilli ka filluar procedurat e tjera. Për të gjithë pozicionet e tjera është dakord.

Alban Toro është kundër.

Fatmira Luli është kundër, me idenë që ai ka të drejtën të konkurrojë në të tëra vendet e shpallura pas datës që i ka mbaruar afati.

Marçela Shehu është kundër sepse vlerëson që zotit {...} duhet t'i bëhen me dije për të zgjedhur të gjitha vendet që janë bërë të lira pas datës 11 qershor, por për të cilat nuk ka filluar procedura e ngritjes në detyrë.

Erjon Muharremaj është dakord me arsyetimin që përderisa ishte pro përfshirjes edhe të vendeve të shpallura si të lira përpara datës 11 qershor, kuptohet që është pro edhe për ato pozicione që janë hapur pas kësaj date.

Brikena Ukperaj është dakord, me të njëjtin arsyetim të bërë më parë.

Medi Bici është dakord, me të njëjtin arsyetim si të zotit Muharremaj.

Maksim Qoku është dakord.

(5 anëtarë janë pro dhe 5 anëtarë janë kundër.)

Zoti Bici sugjeron që zonja Luli duhet të rivotojë pasi zonja Luli ishte fillimisht dakord me mendimin e zotit Bici dhe zotit Muharremaj. Ndërsa zonja Luli ishte për ta shtyrë datën përpara 11 qershorit.

Zonja Shehu shprehet se ligji thotë që vota e Kryetarit është përcaktuese.

Lidhur me këtë, **zoti Muharremaj** shprehet se sipas vlerësimit të tij Zëvendëskryetari ushtron të gjitha kompetencat e Kryetarit në mungesë të tij. Kryetari i seancës, në rastin konkret, ka votën përcaktuese.

Zoti Toska merr fjalën për të sqaruar se ndoshta zonja Luli u shpreh kundër, ndërkohë që ajo që artikuloi në fakt nuk ishte për kundër, pasi tha që është për të gjitha vendet.

Zonja Luli merr fjalën sërish dhe saktëson se ajo është kundra pas datës 11 qershor dhe është për të gjitha vendet që janë shpallur që nga momenti që ai është zëvendësuar në detyrë me dekret të Presidentit. Zonja Luli është pjesërisht kundër dhe bashkohet me shumicën që mbas datës 11 qershor, t'i konsiderohen të shpallura të gjitha vendet, pavarësisht nëse ka filluar apo jo procedura.

Zonja Kadi shprehet në vijim se kështu hapet një precedent sa i përket rivotimit dhe sqaron edhe diçka lidhur me atë që tha zoti Muharremaj, që vota e Zëvendëskryetarit ka apo s'ka vlerë përcaktuese, nuk është ndarë akoma dhe siç dihet, anëtarët e grupit të punës për rregulloren e brendshme janë duke e diskutuar këtë pjesë. Thekson gjithashtu se për këtë, nuk është mbajtur ndonjëherë ndonjë qëndrim, kështu që...

Zoti Qoku, në përgjigje shprehet se meqë doli si problem, ligji është i shkruar dhe le të ndahet, pasi 'ex lege' zoti Qoku është zëvendësues i Kryetares për efekt të ligjit, çka do të thotë që është kryetar i seancës. Ndaj zoti Qoku propozon që derisa të bëhet rregullorja dhe meqë doli si problem, le të sqarohet.

Nëse zonja Luli votoi pro, atëherë nuk është më ky debat, sepse votat janë 6 me 4, -shprehet **zonja Kadi**, dhe sugjeron që votimi të bëhet edhe një herë meqenëse u ndërhy për votën e zonjës Luli dhe që të jetë i qartë edhe në procesverbal mbi votimin përfundimtar.

Rihidhet edhe një herë në votim propozimi i zonjës Ukperaj që për zotin {...} të publikohen të gjitha pozicionet e lira që janë të bërë të tilla pas datës 11 qershor 2020, pavarësisht nëse për to kanë filluar ose jo procedurat e ngritjes në detyrë, përfshirë edhe ndërhyrjen që bëri zoti Toska, të publikimit të pozicioneve të lira në gjykatat e apelit, për të cilat nuk ka asnjë kandidat, dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Brunilda Kadi është kundër për arsyen që u tha edhe më përpara, ku nuk duhet të përfshihen ato pozicione për të cilat ka filluar procedura.

Dritan Hallunaj është dakord, pasi kjo ishte edhe pjesë e propozimit të bërë prej tij.

Ilir Toska është pjesërisht kundër, vetëm për pozicionet për të cilat ka filluar procedura, ka mbaruar afati i kandidimit dhe ka kandidatë në procedurë e sipër.

Alban Toro është kundër, me të njëjtin arsyetim të deklaruar edhe më parë.

Fatmira Luli është dakord, me kundërshtimin e pjesshëm që është pro votimit që të tërë vendet e shpallura zotit {...}, duhet të fillojnë nga momenti që ai është zëvendësuar në detyrë me dekret të Presidentit për zëvendësimin e tre gjyqtarëve. Në këtë kuptim edhe periudha pas datës 11 qershor përfshihet në kohën që zonja Luli ka gjykuar që i takon e drejta për çdo pozicion të shpallur të lirë në gjykata në nivel apeli (në bazë të nenit 62/1).

Marçela Shehu është kundër sepse vlerëson që zotit {...} duhet t'i vihen në dispozicion që të zgjedhë të gjitha pozicionet që janë bërë të lira pas datës 11 qershor 2020, për të cilat nuk ka filluar procedura e ngritjes në detyrë.

Erjon Muharremaj është dakord me arsyetimin që përderisa ishte pro të drejtës së zotit {...} për të zgjedhur ndërmjet pozicioneve të shpallura përpara datës 11 qershor, vetëkuptohet që është pro edhe për ato pozicione që janë shpallur pas kësaj date.

Brikena Ukperaj është dakord, me arsyetim e dhënë më parë.

Medi Bici është dakord, me të njëjtin arsyetim si të zotit Muharremaj.

Maksim Qoku është dakord.

(6 anëtarë janë pro dhe 4 anëtarë janë kundër.)

Pas votimit të anëtarëve, **zoti Toska** specifikon se kush janë gjykatat, duke cituar Gjykatën e Apelit Tiranë, Gjykatën e Apelit Durrës, Gjykatën e Apelit Gjirokastrë,

Gjykatën e Apelit Korçë, Gjykatën e Apelit Shkodër dhe Gjykatën Administrative të Apelit.

Atëherë, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi projektvendimin “Për publikimin e pozicioneve të lira në nivel apeli, për gjyqtarin {...}, që ka të drejtën e caktimit në një pozicion të tillë”, duke vendosur: 1. Publikimin e pozicioneve të lira në nivel apeli, për gjyqtarin {...}, që ka të drejtën e caktimit në një pozicion të tillë, si më poshtë:

- a) Gjykatën e Apelit Tiranë;
- b) Gjykatën Administrative të Apelit;
- c) Gjykatën e Apelit Durrës;
- ç) Gjykatën e Apelit Gjirokastrë;
- d) Gjykatën e Apelit Korçë;
- dh) Gjykatën e Apelit Shkodër.

2. Gjyqtari {...} ftohet për të zgjedhur njërin nga pozicionet e lira në nivel apeli sipas pikës 1, brenda ____ (duhet caktuar një afat nga anëtarët).

Zoti Muharremaj sugjeron që, duke qenë se herën e parë iu caktua një afat zotit {...} 7-ditor, të caktohet sërish afati 7-ditor.

Zonja Kadi drejton një pyetje anëtarëve: “Mos duhet që Këshilli të marrë vendim për të mbyllur procedurat e atij pozicioni që kanë filluar dhe t’u jepet e drejta e ankimit atyre magjistratëve që kanë kandiduar, se mos futet Këshilli në rreth vicioz?!”

(Nga disa anëtarë sugjerohet që të pritët momenti që zoti {...} do bëjë zgjedhjen)

Zoti Toska më pas shprehet se afati më i përshtatshëm është ai që sugjeron zoti Muharremaj, duke llogaritur që Këshilli do bëjë edhe mbledhje tjetër për caktimin e zotit {...}.

(Disa nga anëtarët sugjerojnë që afati të jetë më i shkurtër, 5-ditor.)

Duke marrë në konsideratë mendimet e disa anëtarëve, **Zoti Muharremaj** sugjeron që Këshilli të shprehet brenda datës 28 korrik 2020.

Edhe *zonja Kadi* është dakord me sugjerimin e zotit Muharremaj duke u shprehur se është më mirë me datë sesa të vihen afate dhe të ngatërrohen ditët për shkak të shtunës e të dielës, nëse llogariten apo jo. Më mirë do ishte me datë, sipas zonjës Kadi.

Pra, pika 2 e projektvendimit: 2. Gjyqtari {...} ftohet për të zgjedhur njërin nga pozicionet e lira në nivel apeli sipas pikës 1, brenda datës 28 korrik 2020.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.07.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. **Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
2. **Medi Bici** (anëtar)
3. **Fatmira Luli** (anëtare)
4. **Brunilda Kadi** (anëtare)
5. **Dritan Hallunaj** (anëtar)
6. **Illir Toska** (anëtar)
7. **Alban Toro** (anëtar)
8. **Brikena Ukperaj** (anëtar)

9. Erjon Muharremaj (anëtar)

10. Marçela Shehu (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, **zonja Naureda Llagami**.

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.**
- 2. Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.**
- 3. Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).**
- 4. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).**
- 5. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, për kandidaten znj. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Alban Toro.

Merr fjalën zoti Alban Toro i cili lexon relacionin shpjegues, lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, për kandidaten znj. {...}”.

Ndër të tjera në relacion parashtrohet se më herët, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka bërë hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative dhe atë civile,

përkatësisht me vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar gjyqtarja znj. {...}.

Me vendimin nr. 151, datë 06.05.2020 Këshilli ka filluar procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Lartë, për kandidatët nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionet e lira të shpallura me vendimin nr. 82, datë 26.02.2020 dhe vendimin nr. 85, datë 26.02.2020, ku është caktuar si relator z. Alban Toro.

Në kuadër të administrimit të akteve që do të synonin të vlerësonin verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidates për ngritjen në detyrë, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, relatori ka filluar administrimin e akteve dhe më pas ia ka propozuar projekt-aktin Këshillit, i cili është miratuar me vendimin nr. 214, 18.06.2020, ku Këshilli ka vendosur verifikimin e plotësimit nga kandidatja zonja {...} në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për dy pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative dhe për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 82, nr.83 dhe nr.86, datë 26.02.2020.

Në mbledhjen plenare të datës 28.05.2020, Këshilli ka vendosur hapjen e procedurave për ngritjen në detyrë në gjashtë gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm për katërmbëdhjetë pozicioneve të lira, në fushën e të drejtës civile dhe penale, (vendimet nr. 173-186) si dhe hapjen e procedurave për dy pozicione të lira, për Gjykatën Administrative të Apelit (vendimet nr. 187 dhe nr. 188) ku është lënë edhe një afat i caktuar dhe brenda këtij afati ka kandiduar edhe zonjë {...} (përkatësisht për vendimet nr. 179 dhe nr. 180, datë 28.05.2020).

Në mbledhjen e datës 02.07.2020 nga ana e Këshillit është vënë në diskutim e drejta e kandidimit sipas nenit 48/6 e ligjit nr. 96/2016 për Statusin duke vlerësuar në kuptim të këtij neni gjyqtari mund të kandidojë për ngritjen në detyrë në rastin e çdo shpallje, por në total në jo më shumë se tre pozicione të lira apo që priten të bëhen të lira, të cilat janë në proces (nuk kanë përfunduar), pavarësisht kohës së shpalljes së tyre.

Pas këtij qëndrimi dhe mbas konstatimit se, kandidatja znj. {...} ka kandiduar në total, për 5 (pesë) pozicione të lira në proces (për tre pozicione të lira në Gjykatën e Lartë, të shpallura me vendimet nr. 82, nr. 83 dhe nr. 86, datë 26.02.2020, si dhe për dy pozicione të lira në Gjykatën e Apelit Tiranë, të shpallura me vendimet nr.179 dhe nr. 180, datë 28.05.2020), Këshilli e ftoi këtë kandidatë që të rikonsideronte tre pozicionet e lira për të cilat do të vijonte kandidimin dhe në përgjigje të kërkesës së Këshillit, më datë 03.07.2020 – lexon tekstualisht zoti Toro: “Në përgjigje të emailit tuaj ku më ftoni të zgjedh ndërmjet 5 vakancave ku kam konkurruar, tre prej tyre, pavarësisht se nuk ndaj të njëjtin mendim në lidhje me mënyrën se si interpretohet dispozita ku ju referoni, zgjedh të vijoj konkurrimin për vakancat në Gjykatën e Lartë në fushën e të drejtës administrative të shpallura me vendimet nr.82 dhe nr. 83 datë 26.02.2020 dhe vakancën në Gjykatën e Apelit Tiranë, juridiksioni i përgjithshëm në fushën e të drejtës civile shpallur me vendimin nr. 179, datë 28.05.2020”.

Në këtë kuadër, kandidatja ka shprehur vullnetin për të hequr dorë nga kandidimi në pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Relatori ia paraqiti këtë rrethanë Komisionit, i cili më pas ka paraqitur projektvendimin përkatës i cili në dispozitiv përcakton se:

1. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës civile, të shpallur me vendimin nr.86, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidaten znj. {...}, për shkak të tërheqjes së saj nga kandidimi për këtë pozicion.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen, ndaj hidhet në votim propozimi i ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, për kandidaten znj. {...}” dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Maksim Qoku është dakord.

Atëherë, në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi projektvendimin “Për përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 86, datë 26.02.2020, për kandidaten znj. {...}”, sipas propozimit të ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

**PROCESVERVBAL I PËRMBLEDHUR I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË
LARTË GJYQËSOR**

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 23.07.2020)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Maksim Qoku.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 13:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
2. ***Medi Bici*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ilir Toska*** (anëtar)

7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtar)
9. *Erjon Muharremaj* (anëtar)
10. *Marçela Shehu* (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *zonja Naureda Llagami*.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
2. *Elis Kuçi, Specialist pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
3. *Pjesë nga stafi administrativ i KLGJ-së (nëpërmjet platformës).*
4. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë (nëpërmjet platformës).*
5. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID (nëpërmjet platformës).*

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje është zoti Ilir Toska.

Merr fjalën zoti Ilir Toska i cili lexon relacionin shpjegues, lidhur me përmbajtjen e projektvendimit “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë

26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.

Ndër të tjera në relacion parashtrohet se me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për një pozicion të lirë, duke përcaktuar edhe afatin e kandidimit 8 javë nga dita e publikimit të këtij vendimi. Ky afat është pezulluar fillimisht dhe më pas është zgjatur me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor datë 22.04.2020, duke përfunduar më datë 20.05.2020.

Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe gjyqtarja znj. {...}, aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Me vendimin nr. 191, datë 04.06.2020, Këshilli ka filluar procedurën e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku si relator është caktuar Ilir Toska.

Janë kryet të gjitha procedurat e verifikimit sa i përket 4 kriterëve ligjore të kandidimit, ndërkohë që vijojnë procedurat për kriteret e tjera të kandidimit.

Në lidhje me katër kriteret ligjore të kandidimit për të cilat në vendimin nr. 91, Këshilli ka vendosur që të verifikohen paraprakisht me qëllim për t'i hapur rrugë procesit të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatit që plotëson këto katër kriteret formale, nga verifikimi ka rezultuar si vijon:

Për verifikimin e kandidatës në lidhje me plotësimin e kriterit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale”, është mbajtur në konsideratë se ky kriter përbëhet në vetvete nga dy të tillë, ai për “përvojën e përgjithshme profesionale minimale” dhe ai për “përvojën specifike profesionale minimale”. “Përvoja e përgjithshme” është 10 vjet, ndërsa “Përvoja specifike” është 5 vjet.

Në lidhje me “përvojën e përgjithshme profesionale”, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës në vitin 2008. Ajo ka kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga data 05.10.2007, ndërkohë që, pas përfundimit

të stazhit profesional, kandidatja ka marrë edhe emërimin përfundimtar po në këtë gjykatë. Më pas, në periudhën 15.11.2012 deri në 15.11.2015, kandidatja është komanduar në pozicionin e ndihmësit ligjor në Gjykatën e Lartë. Pas përfundimit të periudhës së komandimit, kandidatja është rikthyer përsëri në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ku vijon të ushtrrojë funksionin e gjyqtarit.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, konfirmohet karriera gjyqësore siç u përmend më sipër, e znj. {...}.

Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, rezulton të ketë mbi dhjetë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

Në lidhje me “përvojën specifike profesionale”, në kërkesat për shprehje interesi të kandidates, evidentohet se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, për periudhat 05.10.2007 - 15.11.2012 dhe 15.11.2015 e në vijim, ajo ka gjykuar çështje të karakterit administrativ, civil dhe penal, ku në këto të fundit si gjyqtare e hetimeve paraprake dhe si plotësuese e trupave gjykuese të seksionit penal.

Gjithashtu në relacion evidentohet edhe informacioni dhe dokumentacioni i përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila ka dërguar informacion për periudhën e stazhit profesional, po kështu për periudhën pas emërimit përfundimtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Gjithashtu jepet informacion për periudhën deri në vitin 2012, moment kur ka kaluar si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë, si dhe jepet informacion sa i përket gjykimeve të çështjeve penale nga ana e gjyqtares, pas rikthimit të saj në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër në nëntor të 2015-ës.

Gjithashtu në relacion jepet edhe informacioni i marrë nga Gjykata e Lartë sa i përket gjyqtarit pranë të cilit zonja {...} ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor, që ka qenë panë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

Nisur nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin

e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 91, datë 26.02.2020, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës penale.

Sa i përket kriterit të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, rezulton se gjyqtarja ka depozituar edhe formularët e vetëdeklarimit për veten dhe për familjarët e afërt.

Sa i përket kriterit të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” është marrë vetëdeklarim nga zonja {...} dhe po kështu është bërë verifikim edhe në dosjen e saj personale dhe është marrë edhe konfirmimi nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit dhe konfirmohet që zonja {...} nuk ka masë disiplinore në fuqi.

Është bërë edhe verifikimi i kriterit të “papajtueshmërisë ambientale”. Edhe për këtë është marrë vetëdeklarimi që zonja {...} ka bërë në momentin e aplikimit dhe ndërkohë nuk rezulton ndonjë e dhënë që zonja {...} të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes së saj në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Materiali paraprakisht është kaluar në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës, i cili ka konsideruar që procedura e verifikimit paraprak, në lidhje me katër kriteret, është e plotë dhe për këtë shkak, çështja i ka kaluar Këshillit të Lartë Gjyqësor për vendimmarrje. Ndërkohë që zoti Toska, si relator i çështjes, ka propozimin sa i përket plotësimit të katër kriterëve formale nga zonja {...} në lidhje me kandidimin e saj për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke propozuar që Këshilli të vendosë: 1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 91, datë 26.02.2020, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ajo edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin

dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.

2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 91, datë 26.02.2020.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë diskutime, pyetje apo sugjerime për çështjen, ndaj hidhet në votim propozimi i ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës mbi projektvendimin “Për verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit” dhe rezultatet e votimit janë si më poshtë:

Ilir Toska është dakord.

Alban Toro është dakord.

Marçela Shehu është dakord.

Brunilda Kadi është dakord.

Dritan Hallunaj është dakord.

Fatmira Luli është dakord.

Erjon Muharremaj është dakord.

Brikena Ukperaj është dakord.

Medi Bici është dakord.

Maksim Qoku është dakord.

Atëherë, në përfundim, Këshilli i Lartë Gjyqësor miratoi projektvendimin “Për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...} të katër kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 91, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”, sipas propozimit të bërë nga zoti Toska.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor